

VENDIM
Nr.1530, datë 19.11.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS ULËZ TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Ulëz të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Ulëz të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.362, datë 23.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ulëz, të qarkut të Dibrës”.

2.Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Ulëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Ulëz

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
12-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
8-11	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve nëshëndetin publik.	Në pronësi
2-7	Varreza publike.	Në pronësi
369, 371-378	Infrastrukturë (Sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
379,382,383,386-388,391, 392,395	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
361-363,365,367, (vetëm kanalet e treta) 380,381,384,385,389,390,393, 394,396	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
397,398	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës – kanalizimeve.	Në pronësi